



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3742/2 prot.

Pogradec, më 18. 08 2021

VENDIM

NR. 75, DATË 17. 08 .2021

**PËR
“MIRATIMIM E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT DHE BASHKISË POGRADEC
PËR OBJEKTIN “NDËRTIM I RRUGËS LIDHËSE POGRADEC –
DOGANË LOTI II”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1 shkronja b, neni 23 pika 14, neni 54, neni 55, të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; neni 5 pika 1.3 shkronja b, të ligjit Nr. 107/2014, date 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Pogradec për objektin: “Ndërtim i rrugës lidhëse Pogradec – Doganë Loti II”; si përfituese e këtij projekti, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i bashkisë:

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Pogradec për objektin: “Ndërtim i rrugës lidhëse Pogradec – Doganë Loti II”, sipas tekstit bashkëlidhur të këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë Pogradec, si autoriteti përgjegjës për planifikimin dhe zhvillimin e territorit të saj administrativ për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT
Sotiraq MANGËRI

